

Në bazë të neneve 20 dhe 32 të Statutit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2016 solli këtë:

VENDIM

**për shpalljen e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës,
Kryetar të Parlamentit Studentor të fakultetit dhe anëtarë të Parlamentit Studentor të
fakulteteve të Universitetit të Tetovës**

Neni 1

Parlamenti Studentor i Universitetit shpall zgjedhje për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Kryetarit të Parlamentit Studentor të fakultetit dhe anëtarëve të Parlamentit Studentor të fakulteteve në Universitetin e Tetovës.

Neni 2

Zgjedhjet Studentore nga neni 1 i këtij Vendimi do t'i realizojë komisioni zgjedhor i Universitetit të Tetovës në pajtim me dispozitat e Rregullores për shpalljen e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës dhe njërive të Universitetit të Tetovës.

Neni 3

Mënyra e dorëzimit të kandidaturave nga paragrafi i kaluar rregullohet me Rregulloren për shpalljen e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit dhe njërive të Universitetit të Tetovës.

Selia e Komisionit Zgjedhor të Universitetit ndodhet në ndërtesën e Rektoratit të Universitetit, në Fakultetin Ekonomik kabinetin nr.106, në rrugën Bulevardi i Ilindenit, p.n. Tetovë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij dhe i njëjti do të shpallet në tabelat e shpalljeve të fakulteteve dhe të Rektoratit të Universitetit.

Tetovë, 12.12.2016

KRYETARI

i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës

Ardian Bilalli

